

VENDIM
Nr. 135, datë 6.3.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 594, DATË 31.8.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘VIJA BREGDETARE E QYTETIT TË VLORËS, FAZA 1, SHTESAT, PJESA LINDORE’, VLORË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 594 datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Vija bregdetare e qytetit të Vlorës, faza 1, shtesat, pjesa lindore’, Vlorë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 3, vlera prej “... 371 116 970.26 (treqind e shtatëdhjetë e një milionë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë pikë njëzet e gjashtë) lekësh” zëvendësohet me “... 382 565 120.26 (treqind e tetëdhjetë e dy milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e njëzet pikë njëzet e gjashtë) lekësh”;

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 382 565 120.26 (treqind e tetëdhjetë e dy milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind e njëzet pikë njëzet e gjashtë) lekësh” përballohet, si më poshtë vijon:

a) 371 116 970.26 (treqind e shtatëdhjetë e një milionë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë pikë njëzet e gjashtë) lekë përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë;

b) 11 448 150 (njëmbëdhjetë milionë e katërqind e dyzet e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë përballohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë.”.

c) Tabelës 2/C, bashkëlidhur vendimit nr. 594, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Vlorë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E BASHKËPRONARVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 594, DATË 31.8.2016, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTT ‘VIJA BREGDETARE E QYTETIT TË VLORËS, FAZA 1, SHITESAT, PJESA LINDORE’, VLORË”, TË NDRYSHUAR

Tabela 2/C

Nr.	Bashkëpronarët			Të dhënat (mbi pasurinë, sipas ASHK-së)				VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË			VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME
								Shpronësim tokë “truall”				
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pas.	Sip. totale (m ²)	Sip. (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
3	Ahmet Velaj Dhurata Velaj Ergys Velaj Fehmi Velaj Liri Velaj Mexhit Haxhiu Napolon Haxhiu Pellumbesha Haxhiu Selauduin Velaj Sonila Velaj Ulsi Velaj Vera Velaj			8602	41/216	Truall	1,050	1,050	10,903	11,448,150	11,448,150	
Vlera totale								1.050	10.903	11.448.150	11.448.150	

Shënim

1. Për tokën “truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”